

## **AKT- THEMELIMI**

### **I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

#### **“Autohaus Swiss” shpk**

Ne Durrës, sot me date 13 Dhjetor 2022 (dymije e njezetedy).

Ortaku i vetem themelues:

**Z.Florian Mulaj**, i datelindjes 20/04/1994, lindur Tübingen Gjermani dhe banues ne Kavaje, shtetas Kosovare madhor, me zotesi juridike për të vepruar identifikuar me leternjoftim ID Nr.413175 dhe numer personal 1232838333, me cilesine e “Ortakut themelues” kerkoi redaktimin e ketij akti themelimi, nepermjet te cilit deklaroi se me vullnet te lire te plote e te sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “Per tregetaret dhe shoqerite tregetare”, ligjin nr.9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, ne ate Doganor,Fiskale Tatimor, krijon shoqerine tregetare, me pergjegjesi te kufizuar, **Autohaus Swiss” shpk**

### **KREU I**

#### **Neni 1**

#### **Krijimi**

#### **“Autohaus Swiss” shpk**

Eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

#### **Neni 2**

#### **Personaliteti juridik**

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne QKB, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqeria **Autohaus Swiss” shpk**, eshte nje shoqeri tregetare, e themeluar nga shtetasi Kosovare **Z.Florian Mulaj**, i cili pergjigjet per detyrimet e shoqerise tregetare dhe mbulon personalisht humbjtet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara. Kontributi i ortakut perben kapitalin e regjistruar te shoqerise.

### **Neni 3**

#### **Selia**

Shoqëria e ka seline në Durres Kruje Nikel , objekt me nr pasurie 107/53 dhe Zone kadastrale 3096 . . Shoqëria mund të ndryshoje seline e saj , te hapë zyra përfaqësie, degë, të krijoj filiale, si brenda dhe jashtë vendit Republikës së Shqipërisë , vetëm me vendimin e Ortakut themelues .

### **Neni 4**

#### **Objekti i veprimtarise**

Sherbim Transporti Nderkombetare .Import eksport I makinave ,pjesëve te kembimit hapje te pikave te servisit, parking automjesh, lavazh.

#### **Neni 5**

#### **Kohezgjatja**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

### **KREU II**

#### **Kapitali**

#### **Neni 6**

#### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 (njqind mije) leke, i ndare ne 1 kuote me vlere nominale 100.000 (njqind mije) leke, i nenshkruar plotesisht nga ortaku vetem themelues ne masen 100%. Pjeset e kapitalit themeltar nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere te tregtueshme. Kontributi i ortakut mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme te paluajtshme apo te drejta). Ortaku vetem pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te kapitalit themeltar te shoqerise.

## **Neni 7**

### **Transferimi i kapitalit**

Kuota e kapitalit tenje shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidarë ndaj shoqërise për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## **KREU II**

### **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

## **Neni 8**

### **Organi Vendimmarres**

Ortaku i vetëm është organi vendimmarres i shoqërise. Ortaku i vetëm është organi vendimmarres i shoqërise që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërise.

Ortaku vendos për çështje si :

- a) Përcaktimi i politikave tregëtare të shoqërise
- b) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- c) Emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabel të autorizuar

- d) Percaktimin e shperblimeve
- e) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregetare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- f) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- g) Miratimin e rregullave procedural te mbledhjeve te asamblese;

Te gjitha vendimet e marra nga ortaku vetem regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhet regjistruar ne veçanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per :

- a) Miratimine pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- b) Shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) Investime;
- d) Vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim , perveç rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.

## **Neni 9**

### **Administrimi**

Administrator i shoqerise “**Autohaus Swiss**” shpk, caktohet **Z.Florian Mulaj**, i cili emerohet per nje afat 5 vjeçar me te drejte ripertritje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te vetem themelues te shoqerise.

## **Neni 10**

### **Kompetencat**

Administratori ka te drejte e detyrohet te :

- a) Kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregetare te shoqrise, duke zbatuar politikat tregetare, te vednosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) Perfaqesoje shoqerine tregetare;
- c) Kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise;
- d) Pergatisi dhe nenshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shpendarjen e fitimeve i paraqesin keto dokumenta perpara asamblese se pergjithshme per miratim

- e) Krijoi nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise
- f) Kryej regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqrise sic parashikohet ne ligjin per QKR.
- g) Raportoi perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare.

Administratori eshte i detyruar te therrase ne mbledhjen e asamblese ne rastet kur :

Sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te asetëve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Administratoret, se bashku edhe vecas njeri tjetrit, kane te drejte te kryejne te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te jashtzakonshem. Administratoret e perfaqesojne Shqiperine perpara te gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo te huaj, autoriteteve shteterore shqiptare apo te huaja, perfshi ketu autoritetet gjyqesore te gjitha shkalleve. Administratoret kane te gjitha kompetencat per te vepruar ne mardhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ja jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratoret angazhojne shoqerine ne mardheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj. Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratorit e kalonte objektin e shoqerise ose per te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk esht prove e mjaftueshme.

## **Neni 11**

### **Viti Financiar**

Viti Financiar i shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 dhjetor. Perjashtimisht, viti i parefinanciar fillon nga data e regjistrimit te shkoqerisë ne QKR dhe mbyllet ne 31 dhjetor.

## **Neni 12**

Shperndarja ose prishja e shoqeris mund te behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj
- b) me vendim te ortakve themelues
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit

- d) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk esht njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 “Per Qendren Kombtare te Regjistrimit”
- e) me vendim te gjykates

Ne kete rast Asamblea merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te shoqeris, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo document te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ shoqeri ne likuidim e siper”.

### **Neni 13**

#### **Baza ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjiit “Per tregtaret dhe shoqerit tregtare”, Kodit Civil dhe cfar do ligji tjetër specific ne Republikën e Shqiperis

### **Neni 14**

#### **Dispozita perfundimtare**

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare ne gjuhen shqipe, me permbajtje dhe vlera te njejta juridike.

Akti i mesiperm pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i shoqerise tregtare Shpk, nenshkruhet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij origjinale .

## **ORTAKU I VETEM THEMELUES**

**Florian Mulaj**